

– SHQIPTAR –
në një dorëshkrim të shek. XVII


Abstract

The object of this study, which I dedicate with great recognition to my colleague and friend Peter Bartl, is recently found in one of the exploratory writings at the end of year 2021 related to an unknown Italian manuscript of the XVII. century on the history of the *Order of Reformed Friars Minor* in the North Albanian Cultural Area (1634-1649). It also contains a short dialogue with two Albanian sentences, where the current ethnonym SHQIPTAR „Albanian“ is also mentioned. Getting acquainted with the digital publication of the facsimile, where this name appears, was arisen the desire to know more closely the circumstances of its use, which simultaneously complements with linguistic facts earlier stages in the development path that this name has experienced until the realization of that function that characterizes its use as a genuine endonym among the bearers of the matrix of ethnic-linguistic Albanian culture today.

After the presentation of this manuscript, as well as updating the reader with the paratextual framework, where this name appears to us, we are focused on the linguistic-philological analysis of the Albanian text with the respective name, which considers in parallel with the diplomatic reproduction and transcription of the Albanian text, and the alphabetical code as well as the dialectal speech conveyed by the text itself. This undertaking also presupposes the clarification of the linguistic ethnicity of the text writer, respectively of the speaker, for which this name is used. The form, the function and diachronic analysis of the use of this name constitute together the concluding part of our work, aiming, in one way or another, at the relative accurate reconstruction of one of the earlier phases which he has traversed in time and space, exactly in that ethnic community that used and still uses Albanian as mean of communication between its members.

Seen from this perspective, we do hope, through the analysis of this new linguistic evidence belonging to the first half of the XVII. century, to have provided additional arguments to our opinion, built years ago in its entirety, when we are continuously devoted to the diachronic and ethnolinguistic research of the endonym SHQIPTAR “Albanian” during its development in space and time (Demiraj 2005; 2010, 2016), just as we are allowed to reiterate again:

“Such a meaning evolution from a simple appellative to an ethnic name may have taken place approximately according to the following way:



is more than possible and is also supported by parallels among other languages and peoples of Europe.” (Demiraj 2010 40)

Keywords: SHQIPTAR “Albanian”, Old Albanian Literacy, Albanian Studies, Ethnolinguistics, Historical Anthropology.

0. Hyrje

Objektin e këtij studimi¹, që ia përkushtoj me stimë të veçantë kolegut dhe mikut tim Peter Bartl, e ndeshim së fundi në njërin ndër shkrimet e natyrës eksploruese të fundvitit 2021 me autor hulumtuesin e zellshëm të arkivave Mark Palnikaj, i cili, krahas kumtit për një dorëshkrim të panjohur italisht të shek. XVII mbi historinë e Urdhrit të Françeskanëve Minorë të Reformuar në Arealin Kulturor të Veriut (1634-1649), përditëson rrethet intelektuale shqiptare me zbulimin e tij të radhës, duke sinjalizuar shfaqjen e etnonimit SHQIPTAR në të, bash në një periudhë që i paraprin me plot gjashtëdhjetë e tre vjet dëshmisë më të hershme shkrimore që njohim për të në një tekst shqip (Fr. M. da Lecce 1702). E këtë kumt fanmirë ai e shoqëron fatmirësisht me një kopje digjitale të faqes faksimile me këtë tekst². Njohja me botimin digjital të kësaj faqeje nxitën komunikimin intensiv të shkruarit të këtyre radhëve me botuesin e saj, duke i dhënë kështu udhë dëshirës me u njohur më nga afër me rrethanat e shfaqjes së këtij emërtimi e duke plotësuar njëherësh me fakte gjuhësore faza të mëhershme në rrugën e zhvillimit që ka përjetuar ky emërtim deri në sendërtimin e atij funksioni etnik-gjuhësor që karakterizon sot e gjithë ditën përdorimin e tij si endonim i mirëfilltë ndërmjet bartësve të matriksit të kulturës etnike-gjuhësore shqiptare.

Pas një paraqitjeje të thukët të dorëshkrimit në fjalë, sikurse përditësimi të lexuesit me kornizën paratekstuale, ku na përshfaqet ky emërtim, do të përqendrohemi në vazhdim të punimit tonë në analizën gjuhësore-filologjike të tekstit shqip me emërtimin përkatës, në të cilën do të mbajmë parasysh krahas riprodhimit diplomatik dhe tejshkrimit të tij, edhe kodin alfabetik sikurse të folmen dialektore, në bazë të së cilës qëndron ky tekst. Kjo ndërmarrje parakupton njëherësh edhe qartësimin e etnitetit gjuhësor të shkruarit të këtij teksti, përkatësisht të folësit, për të cilin përdoret ky emërtim. Forma, funksioni dhe analiza diakronike e përdorimit të këtij emërtimi në tekst rrokin së bashku pjesën përmbyllëse të punimit tonë, ku syzojmë në një mënyrë a një tjetër rindërtimin me saktësi relative të atyre fazave të mëhershme që ka përshkuar ai në kohë dhe hapësirë, shi në atë bashkësi etnike që përdorte dhe përdor shqipen si mjet komunikimi ndërmjet anëtarëve të saj.

1. Korniza para- dhe peritekstuale

Sa i përket dorëshkrimit në vetvete do të mjaftohemi me ato të dhëna që mësojmë në atë përshkrim sado sipërfaqësor që përcjell kumti i Palnikajt (2021) si edhe me do pjesë të dorëshkrimit që na vuri në dispozicion po ai e që rrokin së bashku rreth 112 faqe, ndër to: a) faqet 167-191 ngërthejnë rrethanat e shfaqjes së tekstit shqip me emërtimin në fjalë; si edhe b) 85 faqet e para, po ashtu të numëruara me shifra arabe; së bashku me c) tri fletët e para hyrëse me numërim alfabetik vetëm në *rectus*, ku rroket edhe titulli (f. A), si vijon:

RELATIONE
Universale dell'origine, e successo della Missione
Apostolica de Frati Min.^{ri} Oss.^{ti} Rifor.^{ti}
Del serafico P'rè S. Francisco
nel Regno d'Albania.
Da diversi relationi d'alcuni P'ri Missionarij di
detta Miss.^{ne} raccolta, ordinata, et aumentata
dal P. fra Giacinto da Sospello del
med.^{mo} Ord.^{ne} della Prov.^a di S. Tom.^{so}
Ap'lo, e Prefetto Apostolico di
detta Miss.^{ne} l'anno del

¹ Shkruesi i këtyre radhëve shpreh njëherësh mirënjohjen e thellë ndaj koleges Prof. dr. Anila Omari për korrekturat e vlefshme që ndërmori gjatë leximit të këtij shkrimi. Të njëjtën temë mbi të njëjtën dëshmi gjuhësore ajo e kishte realizuar ndërkohë paralelisht në një punim solid të vetin.

² Siç vë në dijeni autori lexuesin (Palnikaj 2021: 1), i gjithë materiali burimor pritët të shohë së shpejti dritën e botimit edhe si tejshkrim i plotë bashkë me përkthimin përkatës në gjuhën shqip.

1.1 Të dhëna paraprake

Titulli i vëllimit na përcjell në thelb të dhënat kryesore mbi këtë dorëshkrim si raport i përgjithshëm mbi misionin apostolik të Urdhrit Françeskan të Fretërve Minorë të Reformuar në njësinë e dikurshme administrative kishtare “Regno Albania” (Mbretëria e Shqipërisë), e cila përkon pak a shumë me Arealin Kulturor të Veriut katolik shqiptar (Demiraj 2017). Vetë raporti është i natyrës kumulative, ku janë ngjizur së bashku një numër relacionesh të veçanta të hartuara kohë pas kohe dhe rast pas rasti prej disa fretërve françeskanë në njësi të ndryshme të atij misioni. Në titull mësojmë edhe emrin e autorit Padre fra Giacinto da Sospello, atëbotë me funksionin e prefektit apostolik të këtij misioni së paku në gusht të vitit 1652, kur rezultoi t’i ketë dhënë dorën e fundit të gjithë vëllimit në dorëshkrim. Në pjesën hyrëse të dorëshkrimit, që u adresohet drejtuesve kardinalë të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s, mësojmë edhe emrat e relatorëve të veçantë në vëllim, shi në faqen B (*versus*), ku janë të regjistruar fretërit françeskanë: Cherubino Trentino (“di buona memoria, già Prefetto”); Bernardo da Verona, Benedetto Triviano, Antonio da Spoleti dhe Paolino da Sezza. Në mbyllje të pjesës hyrëse (f. C *rectus*) autori saktëson edhe datën e përfundimit të këtij materiali në dorëshkrim në Kotorr, më 12 gusht 1652.

Të dhëna të tjera të natyrës para- dhe peritextuale presim t’i mësojmë të plota, pasi ky material në dorëshkrim të ketë parë i tëri dritën e botimit. Andaj detyrohem t’i referohemi me këtë rast Palnikajt (2021) në shkrimin e cituar më lart, ku ai na kumton se kemi të bëjmë me një material në dorëshkrim me gjithë-gjithë 510 faqe, ndër të cilat 7 faqet e fundit, duket se në zanafillë nuk i përkasin dorëshkrimit në vetvete, meqë janë të hartuara në latinisht në vitin 1644 e për më tepër firmosen nga një tjetër autor Fra Paolo da Mantova. Pjesa kryesore e dorëshkrimit (499 faqe), përpos katër faqeve të para hyrëse me numërim alfabetik, rrok në 6 krerë aktivitetin e misionëve apostolike përgjatë viteve 1634-1649. Faqet që disponojmë lejojnë të mëtojmë paraprakisht së bëhet fjalë për një regjistrim në formën e një kronike historike të aktivitetit të misionit në fjalë, sidomos për vështirësitë e mëdha, me të cilat është përballur qoftë i gjithë misioni në tërësi, qoftë fretër të ndryshëm në ospicet dhe uratorët e veta, të shpërndara në zonat e Malësisë së Madhe (Kelmend), të Dukagjinit (Pult), të Zadrimës, Krujës (Laç) e të Gjakovës e që atë kohë ishin përgjithësisht të përfaqësuar me misionarë të huaj, kryesisht prej Republikës së Venedikut dhe Shtetit të Papës (Marche). Në këtë rrjedhë kronologjike feksni në plan të parë përballja e gjithëhershme e urdhrit: a) me organet e pushtetit lokal deri edhe me ato qendrore që i mbulonte si instanca më e lartë autoriteti administrativ-juridik i Sanxhakut të Shkodrës; sikurse b) me institucionin e kultit islamik, përkatësisht me masën e besimtarëve myslimanë, të cilësuar si *turq*; e në një masë të konsiderueshme edhe c) me probleme që shfaqeshin herë pas here e rast pas rasti në punën e tyre për mbarështimin e grigjës shqipfolëse të besimit katolik, deri edhe d) rropatjet e gjithë misionit për të mbijetuar në kushtet minimale të ekzistencës fizike.

1.2 Rrethanat e shfaqjes së tekstit shqip

Një rrethanë konfrontimi e radhës me institucionin e kultit islamik dhe organet juridike të pushtetit lokal u shfaq edhe në pranverën e vitit 1639, kur misionarë të uratores dhe shkollës së Pëdhanës (= sot Pllanës), më saktë Fra Giacinto da Sospello, atëbotë vikar apostolik i misionit françeskan, u desh të përballej me akuzën e Hoxhë Aliut edhe si kadi i nahijes së Lezhës për aktivitetin antiislamik, parë ky edhe si pjesë e rebelimit që pritej të rrokte, sipas tij, të gjithë zonën administrative vakëf (të besimit katolik) të Zadrimës, për të cilën ushtronte të drejtën e instancës së veçantë (juridike-)administrative një xhabi (: <Giabbí> = turq. *cabi*) si nëpunës i posaçëm dhe tagrambledhës i shtetit osman³. Grindja mori atëbotë përmasat e një procesi

³ Shq. *xhabí* prej tur. *cabi* „hist. ai që mbledh taksat në vakëfet“ (Steuerwald I: 187). Sipas Dizdarit (2005: 1094) *xhabí* përdorej: “1. Qëmotit hollambledhës mbi të ardhurat e vakufëve, zeqatëve etj.; tagrambledhës për vergjinat. Para Tanzimatit, agjent llogaritar që nxirrte taksën për kokë njeriu; it. percettore, testatico.; 2. Në relac. për Frang Bardhin, botue në Bult. Inst. të Shkencave II 163 (1956), *xhabi-ja* cilësohet zyrtar i Turkut të madh (Sulltanit), i

gjyqësor në rang Sanxhaku kundër misionit të Zadrimës, ku u thirrën për pleqësi edhe përfaqësues nahijesh të tjera të Sanxhakut, si p.sh. prej Tivarit, Ulqinit, Lezhës, Krujës së bashku me xhabiun e Zadrimës. Ndër fretërit françeskanë të misionit të Zadrimës, të cilët vuanin prej disa ditësh në paraburgim – pasi u kishin shkatërruar më parë edhe ospicien me uratoren – lexojmë emrin e Fra Cherubino Trentino-s, si i respektuar për nga mosha dhe i sprovuar edhe në punë të shqipes e si i tillë u desh të komunikonte në shqip në emër të gjithë të paraburgosurve me trupin gjykues. Përpos tij, në këtë pjesë teksti na shfaqet edhe emri i Fra Evangelista-s si misionar i ri, gjithashtu i huaj në atë mision.

Teksti shqip rezulton të jetë rrokur në § 23 (f. 188-9) si pjesë e dialogut të zhvilluar në procesin gjyqësor ndërmjet trupit gjykues (A) dhe misionarëve italianë në paraburgim (B), të cilin po ia përcjellim lexuesit fillimisht si riprodhim tonin diplomatik⁴, si vijon:

[f. 188]

<23. Arrivati li frati dal Sangiaccio in presenza di molti Signori di Scuttari, li fù fatto il seguente esame;

A - Voi altri frati, di che paese sete?

B - Respose il Padre Cherubino come più vecchio, e pratico della lingua[:] Siamo d'Italia, e massimi dello stato Veneto.

A - Per chè setè venuti in queste parti?

B – Respose[:] Il nostro Papa, capo della nostra fede, ci hà mandati, per insegnar la Lege, e fede di Gesù Christo.

A - Il vostro Papa, che hà da fare in questo paese che è del Turco?

B - Respose[:] Il nostro Papa hà potestà sopra l'anime da Cristo redente, e massime sopra li christiani, et è obbligato à mandar operaij per tutto il mondo ad insegnare questa santa fede à chi la vuol accettare.

A - Vi hà mandato à convertir' li Turchi, e farli christiani.

B – Respose[:] La lègge nostra dice, chè chi vuol credere, dobbiamo farli christiani, mentre la vogliamo osservare.

A - Non sapete voi, che vi è pena la vita à chi lascia la fede Turchesca, e si fà christiano, e similmente à quelli, che persuadono di farsi?; e come voi altri havete havuto ardire nella Zadrima di far tanti Turchi christiani?

B – Respose[:] Non sapiamo d'havernè fatti; tutta via à chi domanda la legge, noi siamo obligati a dargliela;

A - Come non nè havetè fatto? Io so pure che una volta havete convertito con 13 altri Turchi; [f. 189] E perchè havete fatto questo? Forse non è buona la nostra fede?

B – Respose[:] Il Santo Evangelio dice, che solo la fede di Christo è ~~buona~~ la vera, altra nò.

A - Horsù fatevi voi Turchi, che questo è il meglio, che potete fare, perchè vi vestiremo benissimo, vi daremo bellissimi cavalli, vi teneremo per Paggi; et adotteremo come figli, e vi faremo ricchi.

B - Respose Il Padre[:] *Ëotuné mos e easté maa ban Turco, maa paara Mordien*, che vuol dire: Dio ci guardi di farci Turchi, più tosto la morte.

A - *Ah bregidij Chauuri, c88 schiepatar anst p pertemb8tuné;*⁵ cioè al un tal senza fede, questo, che sà la lingua, è degno d'esser fatto morire,

A - Perchè questi altri facilmente si fariano Turchi et in particolare quel giovine, segnando il Padre Evangelista,

cili nxjerr tributin e të dhetat e drithnave, të venanve e të fryteve tjerë.; 3. Motit (në kohën e Imz. Bizzit), *xhabija* blente prej hyqumetit të Shkodrës, të tanë Zadrimën me pagë, të dheta, zhelepe, nizamije, dhe i nxjerrte vetë si me qenë zabit i vendit (Leka VIII 251 viti 1931)[...]"

⁴ Synimi ynë në këtë hap të parë është thjesht dhe vetëm transliterimi i tekstit burimor, bash ashtu siç na shfaqet në dorëshkrim, pra duke mos vënë dorë asesi në rregullime të ndryshme të natyrës ortografike për italishten e sotme.

⁵ Markimet në kursiv janë ndërmarrë prej nesh.

B - il quale dimandando che cosa dicevano, li disse il Padre, che lo tentavano à farsi Turco, et egli subito rispose con questa parola Albanese: *Jò jò iò*, cioè nò nò nò, più tosto la morte.

Finalmente li licentiarono, e li posero in priggione con buone guardie attorno, e tutta quella notte li maltrattorno con molte parole indecenti...>

2. Analiza filologjike-gjuhësore e tekstit shqip

Riprodhimi diplomatik i paragrafit të mësipërm, ku na shfaqet teksti i vetëm shqip në të gjithë dorëshkrimin (Palnikaj 2021), na lejon ta përcjellim atë si pikë kulmore në dialogun pyetje-përgjigje, të zhvilluar, pas gjase, në gjuhën shqipe. Bëhet fjalë këtu për reagimin shqip të palës së akuzuar (Fra Cherubino Trentino) ndaj ofertës së bërë prej trupit gjykues me ndërruar fenë, përkatësisht për kundërreagimin po shqip në formë fyerje dhe mallkimi prej gjykatësit ase palës akuzuese. Në të dyja rastet shkruesi d.v. shoqëron tekstin shqip, me një përkthim italisht *ad sensum*.

Parë nga perspektiva filologjike-gjuhësore vëmë fillimisht oroe që teksti shqip, i fiksuar në dorëshkrim në kronikën e vitit 1639, përkon me fazën përmyllëse të gjysmës së parë të shek. XVII. Kjo rrethanë shërben si sinor orientues në analizën tonë, meqë mundëson të saktësojmë njëherësh edhe vendin e tekstit në kulturën e shkrimit shqip në Arealin Kulturor të Veriut katolik, bash në një fazë që nga njëra anë pason botimet solide shqip të veprave të Pjetër Budit (Romë 1618 [1636²], 1621) dhe të fjalorit latinisht-shqip të Frang Bardhit (Romë 1635), sindëkur i paraprin ribotimit të tretë të *Doktrinës së Krishterë* të Pjetër Budit (Romë 1664³) e më tej veprës së Pjetër Bogdanit (Padova 1685) ase ndonjë teksti në dorëshkrim që njohim deri sot, siç është p.sh. *Letra e pleqve të Gashit* (Toliq 1689: Bartl & Camaj 1967; Demiraj 2016) etj. Prashtu në kuadrin e analizës filologjike-gjuhësore të tekstit lejohemi të ndërmarrim paraprakisht zgjidhjen e do çështjeve të tilla që kanë të bëjnë së pari me tejshkrimin e tij të sigurt, kodin alfabetik të përdorur në të, sikurse të njehim do karakteristika të së folmes dialektore të fiksuar në tekst, deri edhe në etnicitetin gjuhësor të folësit, përkatësisht të shkruesit të tij.

2.1 Riprodhimi dhe tejshkrimi i tekstit shqip

Riprodhimi diplomatik (B1, A1) dhe tejshkrimi i zgjeruar tekstit (B2, A2) së bashku me domethënien e tij në sqarimet italisht prej vetë autorit në tekst (B3, A3), përkatësisht me përkthimin tonë shqip të atyre sqarimeve (B4, A4), mundësojnë analizën filologjike-gjuhësore të patëmetë të këtij teksti në veçanti, si vijon:

B 1. <Eotuné mos e easté maa ban Turco, maa paara Mordien;>

2. | Zotynë mos e [dh]ashtë mā ban *turco*, mā para mordjen! |

3. <che vuol dire: Dio ci guardi di farci Turchi, più tosto la morte.>

4. “që do me thënë: Zoti na ruajtë, me u bërë turq; më mirë mortin!”

A 1. <Ah bregidij Chauuri, cyy schiepatar anst p pertembytuné;>

2. | Ah, bre gjidī kaūri; kyy shqiepatar ansht [për] për të mbytunë! |

3. <cioè, ah un tal senza fede, questo, che sà la lingua, è degno d’esser fatto morire.>

4. “d.m.th. një i tillë i pafë, ky që di gjuhën, është i denjë me u vrrarë.”⁶

Shtojmë këtu që dialogut shqip i bashkohet dy paragrafë më poshtë edhe pjesëza mohuese shq. *jo!*, e përsëritur tri herë: <*Jò iò iò* ... (it.) no no no>, si reagim i të riut Fra Evangelista ndaj ofertës së bërë atij gjithashtu me u konvertuar në <*turco*>, d.m.th. në mysliman.

⁶ Kemi lënë jashtë çdo lloj komentimi të gjitha ato shmangie sa të dukshme aq edhe të konsiderueshme nga disa perspektiva, sa i përket përpjekjeve me tekstin dhe realizimin përkatës prej Palnikajt (2021), i cili sigurisht ndjek një tjetër synim në punimin e tij.

Tejshkrimi ynë qartëson edhe detaje që lidhen me përmbajtjen e tekstit, ku nga njëra anë shfaqet p.sh. fraza e lidhur: *Zotynë mos e dhashtë...* dhe sharja: *Ah, bre gjidī kaūri(!)*⁷, të cilat autori rreket t'i perifrazojë italisht, si: (it.) *Dio ci guardi*, përkatësisht: *Al un tal senza fede...* Me interes është edhe perifrazimi i kuptimit të emërimit (shq.) *shqiepatar* ~ (it.) *chi sà la lingua*, të cilit do t'i përkushtohemi më poshtë në një paragraf më vete (§3).

Gjatë procesit të tejshkrimit na ra në sy edhe ndonjë pakujdesi e autorit në hedhjen në letër të tekstit shqip. E tillë do parë me siguri përsëritja e pjesëzës gramatikore *për (të mbytnë)* një herë e plotë dhe njëherë me shkurtimin e zakonshëm <ρ> të përdorur rëndom edhe në ortografinë e italishtes për parafrjalën (it.) *per*.

2.2 Kodi alfabetik i përdorur në tekst

Një shmangie tjetër hasim në fakt edhe në grafinë e fjalëformës foljore 3.nj.dësh.tash. <east> për *dhashtë* me grafemën nistore <ε>, e cila në kulturën e hershme të shkrimit shqip në Arealin e Veriut përdoret rëndom dhe vetëm me vlerën njëfunksionale të fishkëllores së zëshme [z]. Kjo shmangie mund të klasifikohet sipas rastit ose si lajthitje e autorit në shkrim, ose më fort me vështirësitë në recepsionin e bashkëtingëllores ndërdhëmbore (shq.) *dh* [ð] në ndërgjegjen gjuhësore të shkruesit jonativ të tekstit shqip. Shmangie të tjera në tekst, si p.sh. përdorimi i parregullt i grafisë <maa> = *mā* në rastin e parë me funksionin e mirëfilltë të pjesëzës gramatikore *me* për ndërtimin e formës së pashtjelluar të paskajores: **me (u) bam* “me u bërë, për t’u bërë”, sikurse përdorimi i emërimit <turco> = (it.) *turco* me grafinë italiane të fjalës janë tregues shtesë, që dëshmojnë etnicitetin e shkruesit ase të folësit në gjyq si folës jonativ i shqipes. Për t’u vënë dukje është edhe fraza tjetër, ajo fyese: *(Ah,) bre gjidī kaūri!* Që, në mos kadiu d.v., së paku pala akuzuese u vesh të pandehurve dhe që është tipike në kulturën orientale-osmane, madje në të gjithë përbërësit e saj⁸.

Një situatë e tillë, që nuk është asses e pazakonshme në kulturën e hershme të shkrimit shqip në Arealin e Veriut, mund të merret edhe si një tregues më shumë për rrethanën që autori zotëron dhe përdor në tekst traditën e shkrimit shqip në këtë areal, ku feks ndër të tjera edhe grafema e veçantë <y> = [y], khs.: <pertembytnë> = [për të mbytnë]; krahas dyfishimit të grafemave zanore si shënjes i gjatësisë funksionale, khs. <maa> = [mā]; <cy> = [kȳ], sikurse <gidij> = [ji’di] etj.

Ndër grafitë e tjera që shfaqen në tekst kemi edhe fjalëformën foljore 3.nj.tash.dëf. <anst>, të cilën e kemi tejshkruar *ad hoc* si [ansht], pra me një bashkëtingëllore hundore, duke mbajtur këtu parasysh që përdorimi i saj si mjet grafik për të shënuar zanoret hundore, i takon pas gjase risive në kod që ndërmori rreth gjysmë shekulli më vonë Pjetër Bogdani (1685).⁹ Pas gjithë gjasash, kështu do parë edhe përdorimi në ndonjë rast në tekst i theksit mbi zanoren <é> për [ə], që deri më sot konsiderohet gjithashtu si risi në kod e Pjetër Bogdanit.¹⁰ Nga një shfletim sado i përciptë i faqeve faksimile që kemi pasur në dispozicion, vërejmë përdorimin e dendur të theksit mbi këtë shkronjë zanore <é, è> në rrokje të patheksuar në tekstin italisht. Prashtu mund të kemi të bëjmë në këtë rast më fort me një veçori në duktusin e autorit e aspak me një ndërhyrje të vetëdijshme lidhur me paraqitjen grafike të zanores qendrore <ë> [ə], të cilën fretërit françeskanë si folës jonativë të shqipes vështirë se arrinin ta perceptonin në ndërgjegjen e tyre gjuhësore.

2.3 Autori dhe e folmja dialektore e përdorur në tekst

⁷ Khs. Dizdari (2005: 117): *bre* < turq. *bre!* “...(shprehje e mohimit të padëshiruar) gjerm. *ach; ach was! Mensch! Du Kerl!*” (Steuerwald I 415); Dizdari (2005: 307): *gjidi* = Si prepozicion qortues, e ma së forti forcues në shprehje të një fjale përbuzëse, fyese: *gjidi shejtan, gjidi mistrec, ... jezit, ...dushman, ... shakë*. Nga një herë edhe mbrapa fjalës: *maskara gjidi [...]* Prej turq. *gidi* (Steuerwald 1988: 415: turq. *gidi* “...verdamter Kerl; Schweinehund...”); sh. edhe Dizdari (2005: 523v.): *kaur* < turq. gâvur “mohues i gjinisë hyjnore, i pabesë, jomysliman” (Steuerwald 1988: 398).

⁸ Shih shën. 7.

⁹ Shih Omari 2015: 60.

¹⁰ Shih Omari 2015: 49.

Ndërsa për etnicitetin gjuhësor të autorit të dorëshkrimit burimor shqip si jo shqipfolës – pas gjase Fra Giacinto da Sospello (?) – nuk gjejmë më shkas për të dyshuar¹¹, lidhur me shqipen që përcillet në tekst, nuk kemi përse të vëmë pikëpyetje, nëse ajo i takon apo jo ndonjë të folmeje të gegnishtes veriore. Krahës autorësisë, edhe shkurtësia e tij vështirësojnë në fakt një hetim me natyrë të mirëfilltë diatopike, sa i përket gjuhës së tekstit. Prashtu fiton me këtë rast përparësi në hulumtim sidomos Zadrima si hapësira ku së paku misiononin ata fretër italianë që ishin ulur në bankën e të akuzuarve në gjykatë, sikurse zhvillimet e vazhdueshme të proceseve gjyqësore në Zadrimë dhe në Sanxhakun e Shkodrës, të cilat gjithsesi përkojnë në tërësinë e tyre me hapësirën grupit të të folmeve të gegnishtes veriperëndimore.

3. Forma dhe funksioni leksikor-semantik i SHQIPTAR në tekst

Asgjëmangut, një shqyrtim të veçantë meriton grafia <schiepatar> në tekst, hetimi i së cilës i jep formë dhe përmbajtje edhe këtij studimi modest.

Tejshkrimi i kësaj grafie si |shqiepatar| = [ʃcɛpatár] mund të kundrohet si lentim *ad hoc*, më saktë duke mbajtur parasysh deri diku rregullat fonotaktike të nyjëtimit të fjalës prej një folësi nativ të shqipes, sidomos sa i përket togut nistor |shq°|, i cili në shkrimet shqip të këtij areali përcillet gjithkund me sekuencën grafike <schEC°> dhe <schiAC°>¹². Në rastin tonë konkret, kjo çështje nuk mund të konsiderohet e zgjidhur patjetër. Mjafton të mbajmë parasysh në këtë rast edhe timbrin e zanores së patheksuar në trup të fjalës: <°pAtar> = [°pAtár], e cila për një shqipfolës pritej të ishte e errësuar në *ë* = [ə], duke u paraqitur kështu grafikisht me shkronjën zanore <e>, sikurse edhe në rastet e tjera në tekst. Si shembull i mirëfilltë në paraqitjen grafike të këtij emërtimi lejohemi të sjellim në përfaqje grafinë e kësaj fjale në fjalorin e Fr. Maria da Lecce-s (1702) – si njohës i shkëlqyer i shqipes –, i cili i drejtohet në hyrje të fjalorit të vet edhe lexuesit shqipfolës me grafinë e patëmetë: <Schippetaarit> = |shqipëtarit| = [ʃcipótá:rit].¹³ Është kjo njëra ndër arsyet, që na yshtin tash të relativizojmë sigurinë e tejshkrimit të propozuar më lart, duke lënë hapur – në varësi me zotërimin e shqipes prej vetë autorit të dorëshkrimit – edhe do variante opsionale, ndër të tjera: *|shqepatar|, |shqiepëtar|, *|shkjepatar|, *|shkjepëtar|, *|skjepatar|, *|skjepëtar|. Përndryshe, lidhur me timbrin [e] (dhe jo *[i]) të zanores së patheksuar në rrokjen e parë, mund të silllet në analizë për një përfaqje deri diku të barazvlefshme edhe ndonjë përmendore e mëhershme e shkrimit shqip, e cila e përcjell këtë variacion po në letër të bardhë, khs. *Formulën e Pagëzimit* të Pal Engjëllit (1462): <...e Spertit Senit> = [...e Shpertit Shenjt] “...e Shpirtit Shenjtë”.

Qartësi shumë më të madhe fitojmë në tekst, sa i përket kuptimit, përkatësisht funksionit semantik në përdorimin e këtij emërtimi. E për këtë ndihmon në radhë të parë sigurisht përkthimi i lirë, më saktë perifrazimi në italisht i kundërpërgjigjes fyese e në formë mallkimi ndoshta prej gjykatësit (kadiut) të asaj çështjeje në gjyq, në mos ndonjë britmë prej xhabiut ase dikujt prej palës pandehëse (shqipfolëse) që pjesëmerrte me shumicë në atë proces.

Gjithsesi fraza përemërore në tekst <...çyç schiepatar...> = |kȳ shqiepatár| përkthehet prej dorëshkruesit e perifrazuar në italisht: |questo, che sà la lingua| = “ky që di gjuhën”, qoftë kjo prej vetë autorit të dorëshkrimit d.v. (Fra Giacinto da Sospello), qoftë – siç vumë në dukje më lart (shën. 11) – e kopjuar prej ndonjë relacioni të shfrytëzuar më parë prej tij. Parë nga kjo perspektivë, në recepsionin e funksionit të mirëfilltë semantik të këtij emërtimi nuk mund t’i anashkalojmë as rrethanës sociolinguistike që – ashtu si i gjithë bordi i fretërve të akuzuar në

¹¹ Përkatësinë etnike-gjuhësore të folësit shqip, pas gjase Padre fra Cherubino Trentino, qoftë edhe si zotërues i patëmetë i italishtes nuk kemi arsye ta vëmë në dyshim: khs. në tekstin shqip: (it.) <...turco>. Gjithsesi, lidhur me autorin që ka hedhur i pari në letër tekstin shqip, potencialisht mund të sillnim në konsideratë edhe praninë e tekstit shqip në ndonjë relacion, ku është mbështetur natyrshëm P. fra Giacinto da Sospello d.v. në dorëshkrimin e vet. (shih §1.1).

¹² Qartësojmë këtu Cover-Symbols të përdorur në këto dy sekuenca: C = çdo bashkëtingëllore; E = çdo zanore e përparme (i, e, y); A = çdo zanore e prapme (a, o, u) dhe ajo qendrore (ë); ° = këputje e strukturës fonematike përkatëse para ose pas rrethit lart; * = formë e rindërtuar me ose pa arsye argumenti.

¹³ Hollësisht Demiraj (së fundi) 2014: 67vv.

atë proces – edhe P. fra Cherubino Trentino nuk ishte folës nativ i shqipes, por që kishte marrë përsipër thjesht rolin e dragomanit. Dhe është pikërisht ky frat <come più vecchio, e pratico della lingua>, të cilit i ngërdheshet me duf fytes në formë mallkimi shqip kadiu ose pala pandehëse.

Nisur nga kjo rrethanë tekstuale lejohemi të mëtojmë paraprakisht pa vrasamendje se emërtimi 'SHQIPTAR' rezulton të ketë qenë i njohur dhe i përhapur së paku qysh në gjysmën e parë të shek. XVII me kuptimin e përgjithshëm “njohës dhe zotërues i shqipes, shqipfolës”, që vjen me thënë 'neutral' sa i përket përkatësisë etnike, pikërisht në Arealin Kulturor të Veriut, ku ai gjëllinte si emër vepruesi i përfutur me prapashitesën {-tár}¹⁴ prej morfemës bazë *shqip* ndf./mb./em. “në gjuhën shqipe; shqip; (gjuhë) shqipe”.

4. Rrugëtimi i emërimit SHQIPTAR në kulturën etnike anase

Rezultatet e analizës formale dhe semantike-funksionale të emërimit SHQIPTAR nuk mund të mos nxisin ndërkohë si reaksion zinxhir rimarrjen e ndonjë problemi ende të diskutueshëm në diskursin kulturor-albanologjik lidhur me rrugëtimin e këtij emërtimi, së paku deri në fillimet e shek. XVIII, kur erdhi dhe u konsolidua mirëfilli i vetëm në përdorim funksioni i tij si endonim për pjesëtarët e asaj bashkësie etnike-gjuhësore në hapësirën e saj kompakte në Perëndim dhe qendër të Ballkanit, e cila përdorte shqipen si mjet komunikimi brenda bashkësisë (së fundi Demiraj 2014: 90vv.). Shfaqja ndërkohë e kësaj dëshmie të re në kulturën e shkrimit shqip që i takon tashmë jo rastësisht gjysmës së parë të shek. XVII, përkatësisht funksioni i saj si shënjes i atij “që njeh e zotëron dhe komunikon në gjuhën anase (shqip)” lejon nga njëra anë qartësimin e marrëdhënieve semantike brenda çerdhes leksikore me fjalën rrënjë *shqip* ashtu edhe rrugëtimin që pritet të ketë përjetuar derivati i saj si fjalëformim më {-tár} qysh prej dëshmisë së kryehershme si llogar familjar që shfaqet në një shumësi variantesh grafike për zonën e Drishtit dhe Raguzës prej gjysmës së dytë të shek. XIV, khs.: <Schipudar ~ Schibudar ~ Schepuder ~ Schapadur ~ Scapuder> (1368 – 1402)¹⁵ e deri te dëshmitë e para në fillim të shek. XVIII, kur SHQIPTAR:

- a) përpos funksionit të tij si endonim që rrokte të gjithë pjesëtarët e asaj bashkësie etnike, që përdorte shqipen si mjet komunikimi, pra duke i zhveshur ata tërësisht prej konotacionit të përkatësisë (etnike-)fetare: *katolik-romak* = *arbënor*, *l(ë)ti* ~ *ortodoks (grek)* = *urum*, *grek* ~ *ortodoks sllav* = *shqa* (Demiraj 2014: 124; 163vv.);
- b) vërejmë të regjistrohesh gjithashtu edhe me një kuptim me konotacion, në dukje, asnjëherë si “gojëtar, (it.) parlator”: <parlatore = goetaar, schippetaar, -i, -a> (Fr. M. da Lecce 1702: 8694; hollësisht Mandalà 2009: 152vv.; Demiraj 2014: 134vv.)

Asgjëmangut, spektri semantik që rrok derivatin SHQIPTAR përgjatë fazës së kristalizimit të shkallëshkallshëm deri si endonim i mirëfilltë në bashkësinë etnike-gjuhësore shqiptare: shek. XIV-XVIII, është vështirë të kundrohet larg spektrit përkatës të fjalë-rrënjës *shqip* në polivalencën e saj (ndajfoljore vs. mbiemërore, emërore) “(gjuhësisht) qartë, kuptueshëm” vs. “shqip” si mënyrë a mjet komunikimi ndërmjet folësish nativë, përkatësisht me njohës jonativë të gjuhës shqipe.

5. Përfundim


Parë nga kjo perspektivë studimi, shpresojmë që me shqyrtimin e kësaj dëshmie të re gjuhësore që i takon gjysmës së parë të shek. XVII të kemi plotësuar me argumente shtesë atë hulli interpretimi të sendërtuar në tërësinë e vet vite më parë prej nesh, kur i jemi përkushtuar në vazhdimësi shqyrtimit historik dhe etnolinguistik të endonimit SHQIPTAR në kohë dhe hapësirë (Demiraj 2005; 2010, 2016), bash ashtu siç lejohemi ta përsërisim tash, si vijon:

“Duke mënjeluar çdo hollësi lidhur me shkallën e sigurisë që bart njëra apo tjetra etimologji e dhënë për fjalën *shqip* – çështje kjo që në fund të fundit nuk ka të bëjë

¹⁴ Hollësisht Demiraj (edhe) 2014: 90vv., 134vv.

¹⁵ Në këtë shumësi variantesh forma *Schipudar* është me e shpeshta (= 4 raste).

drejtpërsëdrejti me synimin i këtij studimi – lejohemi t’i bashkohemi mendimit të HAHN-it, të mbështetur edhe nga Meyer-i, të cilët pranojnë një bashkëlidhje të ngushtë midis *shqiptar* *‘‘shqipfolës; ai që ka shqipen gjuhë amtare’’ me *shqipoj/shqip(ë)toj* (fol.) ‘‘nyjëtoj; kumtoj’’ (← *‘‘kuptoj; flas qartë, kuptueshëm’’) nga njëra anë dhe me *shqip* (ndf.) ‘‘në gjuhën shqipe’’ (← *‘‘qartë, kuptueshëm’’). Një zhvillim i tillë kuptimor nga një apelativ i thjeshtë në një shënjesë etnik pak a shumë sipas kësaj rruge:



është më se i mundshëm dhe gjen paralele edhe në gjuhë dhe popuj të tjerë të Europës^{16, 17}

Përfundojmë këtu këtë punim modest që ia përkushtuam SHQIPTARIT tonë Peter Bartl *questo che sà la storia d’Albania e degli albanesi*, që vjen me thënë atij na ka mësuar gjithherë *qartë e shqip* historinë e hapësirës kompakte shqipfolëse në shekuj.

6. Bibliografi

6.1 Burime

Bardhi, Fr. [= Franciscus Blanchus]

1635 Dictionarium latino-epiroticum. Per R. D. Franciscum Blanchum, Romæ 1635.

Bogdani, P. [= Peter Bogdan]

1685 Cvnevs Prophetarum de Christo Salvatore Mvndi, et eivs Evangelica Veritate; italice, et epirotice contexta; Et in duas Partes divisa a Petro Bogdano macedone [...]. Patavini 1685.

Budi, Pjetër (= <Peter Budi>)

1618 Dottrina Christiana. Composta per ordine della fel.me di Papa Clemente VIII. Dal R.P. Roberto Bellarmino Sacerdote della Compania di Jesv. Adesso Cardinale di santa Chiesa del Titolo di S. Maria in Via. Tradotta in lingua Albanese dal Rever. Don Pietro Bvdi da Pietra Biancha. In Roma, Per Bartolomeo Zannetti (botime të tjera: Romë 1636⁽²⁾, 1664⁽³⁾, 1868⁽⁴⁾)

1621 Ritvale Romanum et Specvlum Confessionis... Romæ.

Kuvendi i Arbënit

1706 Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit; Mbelieçune nde viett gnai mije sctat cint e tre ndene Clementit i Gnimiçietmi Pape Pretemaçit, Romæ, Typis Sac. Congregationis de Propaganda Fide, Anno MDCCVI (riprodhim me fototipi në: “Kuvendi i Arbënit” Prishtinë 2003 – Botues Konferenca Ipeshkvore Shqiptare – f. 133-245).

Da Lecce, Fr. M.

1702 Dittionario Italiano – Albanese (dsh.). Botim kritik me hyrje dhe fjalësim shqip, përgatitur nga Gëzim Gurga. Botimi I, Shkodër 2009.

Engjëlli, Pal (= Paulus Angelus)

1462 Formula e pagëzimit – citat në: “Constitutiones, Ordinationes et Saluta”. Shih

Da Sospello, Giacinto

¹⁶ Shih Ismajli 1985 230; Sh. Demiraj 1999 194.

¹⁷ Demiraj 2010: 40; 2014: 101.

- 1652 Relatione | Universale dell'origine, e successo della Missione | Apostolica de Frati Min.ri Oss.ti Rifor.ti | Del serafico P'rè S. Francisco | nel Regno d'Albania. | Da diversi relationi d'alcuni P'ri Missionarij di | detta Miss.ne raccolta, ordinata, et aumentata | dal P. fra Giacinto da Sospello del | med.mo Ord.ne della Prov.a di S. Tom.so | Ap'lo, e Prefetto Apostolico di | detta Miss.ne l'anno del | Sig.ri 1652.

6.2 Literaturë e cituar

Altimari, Francesco

- 1994 Alcuni etnici di origine albanese nei dialetti di Calabria, në: "Scripta minora albanica", në serinë: "Quaderni di Zjarri", Rende 1994 (1992), f. 47-57.

Bartl, Peter

- 1995 Albanien. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart, Regensburg 1995.
1967 & Camaj Martin: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689, në: "Zeitschrift für Balkanologie" nr. 5 23-33.
2009 & Demiraj, Bardhyl: "La lettera dei frati di Pulati (1761), il suo sfondo storico ed il suo posto nella cultura della scrittura albanese", në: "Nordalbanien – L'Albania del Nord. Linguistisch-kulturhistorische Erkundungen in einem unbekannten Teil Europas" (botues Monica GENESIN & Joachim MATZINGER). Hamburg, 63 –79.

Camaj, Martin

- 1967 & Bartl, Peter. Shih më lart Bartl 1967.

Demiraj, Bardhyl

- 2005 Shqiptar!, në: "Seminari i 24-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë, gusht 2005", Prishtinë, f. 105-135.
2008 (bot.): Dictionarium latino-epiroticum. Per R. D. Franciscum Blanchum, (Romæ 1635), Shkodër.
2009 & Bartl, Peter. Shih më lart: Bartl 2009.
2010 Albanian – Shqiptar. Tiranë.
2012 (bot.) Concili Provincialis o Cuvendi j Arbenit (Romæ 1706). Botim kritik, Botime françeskane, Shkodër 2012.
2014 Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë. Tiranë.
2016 Grimca biografike për autorët tanë të vjetër. IV. Gjergj Toliq si hartues i Letrës së Pleqve të Gashit (1689), në: "Hylli i Dritës" nr. 2, f. 41-54, Shkodër.
2017 Arealin Kulturor të Veriut katolik shqiptar. Tiranë.

Demiraj, Shaban

- 1999 Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Tiranë.

Dizdari, Tahir

- 2005 Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe. Tiranë.

Gurga, Gëzim

- 2009 (bot.) Át Francesco Maria da Lecce O.F.M.: Dittionario Italiano-Albanese (1702). Botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip. Shkodër.

Ismajli, Rexhep

- 1985 Gjuha shqipe e kuvendit të Arbënit (1706), Prishtinë.

Mandalà, Matteo

- 2009 *Shqip, shqipëtar e shqipëni* në Fjalorin e pabotuar (1702) të Francesco Maria da Lecce-s, në: "Vepra themelore në Albanologji. Aktet e konferencës shkencore ndër-kombëtare 18-20 dhjetor 2008" (bot. A. Marashi). Tiranë, f. 152-161.

Matzinger, Joachim

- 2010 Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2: Verschriftung des Albanischen mit Schwerpunkt auf Paulus Angelus und Gjon Buzuku. In: (B. Demiraj – ed.) Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet. In: „Albanische Forschungen“, bl. 29. Wiesbaden, f. 421-486.

Omari, Anila

- 2015 (bot.) Pjetër Bogdani: Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve). Botim kritik. Përgatitur nga Anila Omari. Tiranë. (2005¹)

Palnikaj, Mark

- 2021 La parola “shqiptar – albanese” fu scritta prima di quanto si pensava (Sull’un manoscritto dell’anno 1634) = Fjala SHQIPTAR u shkrua 70 vjet më parë nga sa njihej më përpara (Mbi një dorëshkrim të vitit 1634), në: “Rrënjët – le radici”, anno 19; nr. 6; Dicembre 2021, f. 1.

Steuerwald, Karl

- 1988 Türkçe-almanca Sözlük, bl. I. Wiesbaden. (1972¹)